

28-09-2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtar ligjor Burim Haxhidema, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga Prishtina, rr. [REDAKTUAR] p.n, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.178-3/17 të dt 23.03.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.11.04.2017 solli:

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.178-3/17 të dt 23.03.2017 dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] nga Prishtina, rr. [REDAKTUAR] p.n, I lindur me datë, [REDAKTUAR] në fsh. [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr personal [REDAKTUAR] mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse më dt. 18.01.2017 rreth orës 19:40, në rrugën magjistrale në udhëkryqin me rrugën "Driton Islami", në Ferizaj duke drejtuar automjetin e tipit "Audi" ngjyrë zezë me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] nga pakujdesia duke menduar me mendjelehtësi se deri te aksidenti nuk do të vij, ka rrezikuar jeten e njerezve dhe te pasuris në kundërshtim me nenin 46.1 pika 1 të LSKRR-së, gjat kyqjes në komunikacion për në rrugën magjistrale, nuk e rrespekton përparsin e kalimit për pasojë me pjesën përparme goditet në pjesën e përparme të anës së majte nga automjeti i tipit "VW Passat" ngjyrë hiri, me targa [REDAKTUAR] të cilën e drejtonte [REDAKTUAR] e cila ishte duke qarkulluar në drejtim të Ferizajt, ku përveç dëmeve materiale, lëndime trupore pëson [REDAKTUAR]

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuares [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna-Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 90.88 Euro dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.178-3/17 të dt 23.03.2017 ka akuzuar [REDAKTUAR] nga Prishtina, rr. [REDAKTUAR] p.n, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësishtë konstatimin e ekspertit mjeko ligjor Dr. [REDAKTUAR] i dt.03.03.2017, mendimin e ekspertit të komunikacionit rrugor, Ing [REDAKTUAR] e dt.16.02.2017, dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së e dëmtuara, [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna-Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.


Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 90,88 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.718/2017 i dt.11.04.2017

Zyrtari Ligjor
Burim Haxhidema

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.